



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-320/01-44644 të datës 05.09.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 26.09.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR INICIATIVËN PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS - IADK

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 8.700.00 € (tetë mijë e shtatëqind euro), Iniciativës për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës-IADK, konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-320/01-44644 të datës 05.09.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-320/01-44644 të datës 05.09.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK , sipas kostonë së bashkëfinancimit të përcaktuar për vitin 2024 për Komunën e Lipjanit me qëllim të implementimit të projektit të përbashkët me titull "Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë", financuar nga Agjensioni Suedez në Kosovë (Sida) ku Këshilli Danez për Refugjatët (DRC) do të menaxhojë fondet nga Sida kurse Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) do të implementojë projektin i cili konform Marrëveshjes së cekur në Komunën e Lipjanit do të jetë dy vjeçar.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për vitin 2024 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 12-320/01-48091

Lipjan, më 26.09.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

